



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR.11

Rrogozhinë, më 26.11.2025 ora 13 : 00 ^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.5065.Prot datë 21.11.2025, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.10, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 20.10.2025.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2025 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Mbi Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore viti 2026 për Bashkinë Rrogozhinë”.
- 6- Raport nga Njësia e Auditit të Brendshëm mbi punën e bërë dhe problematikat e evidentuara në Bashkinë Rrogozhinë .
- 7- Raport mbi zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar-Shtator 2025.
- 8- Informacion Këshillit Bashkiak mbi raportin e komisionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit për z. R. Thartori.
- 9- Informacion Këshillit Bashkiak mbi raportin e komisionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit për z. E. Dahri.
- 10- Informacion shtesë nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sportit për Presidentin e Republikës së Shqipërisë SH.T.Z. Bajram Begaj.
- 11- Njoftim për gjetjet e barometrit në nivel kombëtar dhe specifikisht për bashkinë Rrogozhinë.
- 12- Shqyrtim i kërkesës për informacion nga anëtari i Këshillit Bashkiak z. Mitat Daja.
- 13- Informacion mbi veprimtarinë dhe masat e marra nga Policia e Shtetit për menaxhimin e



situatës së zjarreve që prekën Bashkinë Rrogozhinë në stinën e verës 2025.

14- Raport nga Administratorët e Njësive Administrative , mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor-Tetor 2025.

15- Të ndryshme.

-Kërkesë nga z. Endri Demarku, Kryetar i Këshillit Vendor Rinor Bashkia Rrogozhinë.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Mitat Daja, Saimir Cani, Besnike Coraj, Merilin Saraçi, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Hekuran Xhani, Lije Dedej, Dhurata Meka, Sokol Gosa, Lorena Baku, Altin Tosku, Renato Kalemi, Shpati Kolgega, Erind Tosku.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Astrit Mertiri - Administratori i Njësive Administrative Kryevindh.
4. Deshir Gjumsi - Administratori i Njësive Administrative Lekaj.
5. Denis Sako - Administratori i Njësive Administrative Gosë.
6. Mexhit Saliu - Administratori i Njësive Administrative Sinaballaj.
7. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
8. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
9. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
10. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
11. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
12. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
13. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
14. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
15. Besnik Dushku - Shefi i MZSH-së
16. Nuredin Tosku - Përgjegjës i Njësive të Auditit të Brendshëm të Bashkisë
17. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :



Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore. Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, 11- Këshilltarë.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Mitat Daja, Saimir Cani, Besnike Coraj, Merilin Saraçi, Indrit Dedej, Silvana Aliu, dhe Mukades Gixhari.

-Lexojmë Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 20.10.2025 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar janë si më poshtë :

Vendim nr . 38 . Për dhënien e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak Rrogozhinë znj.

Dhurata Meka

Vendim nr . 39 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%

Vendim nr . 40 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2025 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr . 41 . Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë.

Gjithashtu lexojmë dhe konfirmimin ligjor të ardhur nga prefekti i qarkut Tiranë për vendimet e datës 20. 10.2025:

Vendim nr . 42 . Për dokumentacionin dhe kriteret e kërkuara për përfitimin e bursave në arsimin parauniversitar.

Konfirmohet në parim referuar ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar me institucionet arsimore publike”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin Prefekt : Afrim Qëndro.



Mukades Gixhari . Para se të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës do të gjeni të fotokopjuara secili 4-projektvendime dhe nje kthim pergjigje :

Projektvendim për miratimin e kërkesës së z. Hekuran Dedej.

-Ky projektvendim ka marrë miratimin dhe të komisionit të financës i cili është mbledhur ditën e djeshme ora 13:00.

Projektvendim për miratimin e kërkesës së Shoqatës Humanitare “3 Dhjetori”.

-Ky projektvendim nuk ka marrë miratimin e komisionit të financës i cili është mbledhur ditën e djeshme ora 13:00.

3. Projektvendim për dhënien e ndihmës së menjehershme ekonomike për familjet në nevojë për znj. Hava Dedej.

Projektvendim për shpalljen “qytetar nderi” (pas vdekjes) z. Ramazan Thartori.

-Për këtë çështje keni bashkëngjitur dhe raportin e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit të cilët janë mbledhur me datë 10.11.2025 dhe janë shprehur pro dhënies së titullit z. Ramazan Thartori.

5. Keni dhe shkresen kthim pergjigje drejtuar këshilltarit z. Mitat Daja.

Jeni dakord t’i përfshijmë në rendin e ditës këto 4 projektvendime dhe kthimin e përgjigjes për këshilltarin dhe t’i trajtojmë në pikën të ndryshme?

-Miratohet me 11-vota pro, përfshirja në rendin e ditës e 4 projektvendimeve dhe kthimit të përgjigjes për këshilltarit si më lart cituar.

Mukades Gixhari . Jeni dakort me rendin e ditës?

Enver Memolla . Me ndryshim apo pa ndryshim?

Mukades Gixhari . Siç e diskutuam me ndryshimin.

Enver Memolla . Pika 10 do hiqet?

Mukades Gixhari . Po pra, siç e diskutuam. Jeni dakord me rendin e ditës? E hedhim në votim pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 1 (një) e rendit të ditës me heqjen e pikës 10 nga shqyrtimi në këtë seancë dhe futjen e 4 projektvendimeve dhe një kthimi përgjigje për këshilltarin z. Mitat Daja.



Mukades Gixhari . Miratim i procesverbalit Nr.10, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 20.10.2025. E hedhim në votim. Pro, kundra, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 3, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani. Përshëndetje z. Ledian fjala për ju.

Ledian Hasani . Janë 13-familje përfituese dhe fondi është 60-mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Informacionin e keni të gjithë përpara. Ka ndonjë pyetje? E hedhim në votim. Pro kundra absenim të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 3 (tre) e rendit të ditës.

Vendim nr. 43. Miratohet me 11 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.5051.Prot datë 21.11.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2025 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.5051/1.Prot datë 21.11.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2025 nga fondi i pushtetit vendor”. Vazhdojmë po me drejtorin e mbrojtjes dhe kujdesit social.

Ledian Hasani . Janë 23-familje përfituese dhe fondi është 105 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje rreth kësaj pike? E hedhim në votim. Pro, kundra, abstenim të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr. 44. Miratohet me 11 vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.5050.Prot datë 21.11.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2025 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.5050/1.Prot datë 21.11.2025.



Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 5... atëherë meqë kemi drejtorin kemi projektvendimin “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë për znj. Hava Dedej”.

Ledian Hasani . Atëherë zonja është 90-vjeçe jeton e vetme me një pension prej 94 mijë lekësh, infomracionin e mora nga Veri për pjesën e pensionit, shtëpia është e amortizuar totalisht, është përfituese tek rindërtimi tek tërmeti për momentin kemi menduar ta lejmë me ndihmën e menjëhershme ekonomike të mundohemi t;’i gjejmë një shtëpi për ta shpërngulur nga aty ku jeton, se kushtet janë shumë të vështira.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje E hedhim në votim, pro, kundra, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, projektvendimi me Nr.5101.Prot datë 26.11.2025 “Për dhënien e ndihmës së menjehershme ekonomike për familjet në nevojë”

Vendim nr.45. Miratohet me 11 vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.5101.Prot datë 26.11.2025 “Për dhënien e ndihmës së menjehershme ekonomike për familjet në nevojë” si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.5101/1.Prot datë 26.11.2025.

Mitat Daja . Kisha unë diçka para se të fillosh me pikën tjetër.

Mukades Gixhari . Më fal me z. Ledian e ke?

Mitat Daja . Jo kam diçka tjetër, kam bërë një kërkesë për informacion të më falësh pak i kam kërkuar leje dhe kolegëve. Kam thënë që informacioni të më vihet në dispozicion mbledhjen e këshillit bashkiak, unë kam pritur që të kishta diçka të shkruar aty të kishte informacion i shkruar por nuk shoh gjë informacion këtu.

Edison Memolla . Do të përgjigjem unë.

Mukades Gixhari . z. Mitat e kemi pikë më vete atë.

Mitat Daja . Unë e kërkoja kështu, e kërkoja informacionin e shkruar, meqë ato nuk kanë denjuar që ta sjellim informacionin edhe unë nuk kam pse të rri më shumë.



Mukades Gixhari . Do qëndroni sepse nuk kemi ardhur tek pika juaj zoti Mitat, e keni në rendin e ditës.

Mitat Daja . Për muhabet ulemi pijmë kafe bëjmë muhabet, këto janë pyetje që i ndërton publiku nuk është puna që unë jam duke ndërtuar pyetje nga koka ime dhe publiku kërkon informacion për seriozitet dhe për korrektsi dhe administrata duhet ta kishte sjellë informacion.

Edison Memolla . Përgjigjen e kam do ta lexoj dhe do ta jap po prite, prit po s'prite ...

Mitat Daja . Duhet të ishte informacion i dhënë.

Edison Memolla . Kujt?

Mitat Daja . Administrata duhet ta kishte sjellë informacionin në mbledhjen e këshillit bashkiak duhet të ishte këtu, gjithë këshilli bashkiak ta kishte informacionin.

Edison Memolla . Tek disa kërkesa nuk do të kthehen përgjigje do t'i jap unë me zë.

Mitat Daja . Tani ky nuk është muhabet ndërmjet dy njerëzve sepse ne jemi miq dhe shokë ne jemi shumë mirë por këto janë interesa publike që njerëzit i kanë edhe duan t'i dëgjojnë dhe duan të marrin informacion.

Edison Memolla . Këtu jemi institucion, miq jemi jashtë institucionit.

Alime Hoxha . Për pjesën e kërkesës së Mitatit, zoti Mitat ka të drejtë kërkojë nga këshilli një sekond thjeshtë do të them diçka, e lexova edhe pak kërkesën dhe aty kërkohet një informacion që unë besoj që nuk është tagër i këshillit që ta marrë këtë informacion nuk mund të diskutohen në këshill emrat e drejtorëve e kanë dhënë apo nuk e kanë dhënë dorëheqjen, pse e kanë dhënë dorheqen. Nuk është tagër i këshillit të merret me punësimet...

Mitat Daja . Dakord të më japë një informacion me shkrim.

Alime Hoxha . As me shkrim as me gojë, ky informacion është konfidencial...

Mitat Daja . Mirë unë po vazhdoj se kam vendos që do vazhdoj.

Alime Hoxhanuk besoj që ky informacion duhet t'i jepet këshillit se kush nga drejtorët ka



dhënë dorheqen, pse e ka dhënë dorheqen ai është urdhër i bashkisë kështu e mendoj.

Mitat Daja . Në rregull.

Mukades Gixhari . Zoti Mitat mund të qëndrosh të vijnë tek pika juaj sepse të njëjtën situatë e pati edhe zoti Indrit dhe zonja Silvana me kërkesën në mbledhjen e mëparshme dhe ju dhanë përgjigjet të gjitha një për një.

Edison Memolla . Atëherë funksionin kështu kjo lloj kërkesë është kërkesë individuale.

-Mbledhjes i bashkohet këshilltarja znj. Gezime Met-hasani në minutën e 10 të zhvillimit të saj.

-Mbledhjes i largohet këshilltari z. Mitat Daja në minutën e 11 të zhvillimit të saj.

Silvana Aliu . Atëherë në mënyrë private i ka shkuar zotërisë?

Edison Memolla . Në mënyrë private nuk shkojnë...

Alime Hoxha . Po edhe private nuk mund të shkojnë emrat, sido që të jetë.

Enver Memolla . Këshilli bashkiak ka të drejtë kur miraton strukturën... brenda strukturës kryetari është vetë që emëron nuk është i zgjedhur punonjësi është i emëruar.

Silvana Aliu . Pak a shumë mua më duket një diçka falso kjo, sepse për të ik me personat takoheni dhe jeni nëpër tavolina dhe mund ta diskutoni dhe e keni bërë bisedë diskutimi dhe të vish ta kërkoj sa për sy e faqe nuk e mendojmë sepse ne jemi koshient sesa është Rrogozhina dhe ne e dimë shumë mirë që kush ka dhënë dhe kush nuk ka dhënë dorëheqjen. Se çfarë bëni ju në bashki personalisht po ja themi që Mitati do për publikun, po ja them dhe publikut nuk më intereson. Mua më intereson të jeni pranë qytetarëve, të zbatoni ligjin me atë, pjesa tjetër është e juaja.

Alime Hoxha . Është e vërtetë që bashkia të jetë në funksion të qytetarëve por nuk mund të kërkojmë emrat pse ka dhënë dorëheqjen.

Silvana Aliu . Për show mund ta bëjnë por nuk më intereson kush jep dorëheqjen.

Edison Memolla . Unë mora përsipër të ja kthej dhe këtë përgjigje.



Indrit Dedej . Ne i thërrasim drejtorat për punën që bëjnë, ne kemi të drejtë të verifikojmë punën që bëjnë drejtorat dhe t'i thërrasim në raport emërimet shkarkimet nuk janë...

Silvana Aliu . Emërimet shkarkimet janë pjesë e juaja..

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me rendin se e kapërcyem, vazhdojmë me pikën 5 aty ku e lamë, miratim i projekt - vendimit, “Mbi Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore viti 2026 për Bashkinë Rrogozhinë”. Për dijeni ky projektvendim është konsultuar me publikun si dhe ka marrë miratimin e komisionit të financës. Relaton drejtoresha e të ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik znj. Marsida Thartori .

Marsida Thartori . Përshëndetje siç është diskutuar më parë sistemi i taksave dhe tarifave janë bërë diskutime edhe nga komisioni i ekonomisë dhe financave. Janë shtuar të gjithë propozimet në draft në dokumentin përfundimtar është shtuar taksa e re e infrastrukturës arsimore. Kam bërë ndryshimet e nevojshme të bazave ligjore dhe përpara miatimit të draftit final dhe është sjellë për miratim. Nëse ka ndonjë diskutim...?

Alime Hoxha . Atëhere paketa fiskale është diskutuar edhe tek komisioni i ekonomisë dhe ne si komision kemi rënë dakord që paketa të kalojë ashtu siç është tani nëse ka diskutime nga anëtarët e këshillit.

Mukades Gixhari . Keni ndonjë pyetje që dhe komisioni e ka trajtuar. E hedhim në votim, pro kundra, absenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr.46. Miratohet me 11 vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.5052.Prot datë 21.11.2025 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Rrogozhinë viti 2026”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.5052/1.Prot datë 21.11.2025, Relacionin shpjegues për “Taksën për Infrastrukturën Arsimore” të drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve shkresa me Nr.4822.Prot datë 07.11.2025.

Marsida Thartori . Faleminderit.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Kalojmë në pikën 6, raport nga Njësia e Auditit të Brendshëm



mbi punën e bërë dhe problematikat e evidentuara në Bashkinë Rrogozhinë .Relaton përgjegjësi i Njësisë së Auditit të Brendshëm të bashkisë z. Nuredin Tosku.

Ervis Shera . Për 5 minuta vjen përgjegjësi.

Mukades Gixhari . Kalojmë tek pika tjetër, Vazhdojmë pikën 7 raport mbi zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar-Shtator 2025. Relaton Drejtoresha Juridike znj. Enkela Ballabani.

Edison Memolla . Unë e kam raportin sikur e keni edhe ju . Për të gjithë vendimet që janë marrë drejtoritë kanë sjellë raportin e tyre si dhe njësitë administrative. Nuk e di nëse keni ndonjë pyetje konkrete ose tualexoj fjalë për fjalë se është goxha voluminoz.

Mukades Gixhari . Materialin e kanë të gjithë, e kanë lexuar në qoftë se kanë ndonjë pyetje. Atëherë është raport ... kalojnë ne pikën 8 informacion Këshillit Bashkiak mbi raportin e komisionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit për z. R. Thartori. Meqë na ka ardhur dhe projektvendimi vazhdojmë tek të ndryshmet siç e kaluam. Kalojmë në pikën 9, Informacion i Këshillit Bashkiak mbi raportin e komisionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit për z. Enver Dahri. Materialin e keni të gjithë. Atëherë po Silvana je anëtare e komisionit dhe zëvendëskryetare.

Silvana Aliu . Atëherë për mësuesin Enver Dahri ne kemi rënë dakord si komision që mësuesi për kontributin që ka dhënë t'i jepet “Çertifikatë Mirënjohje” për të gjithë që do , e kemi marrë si nismë këtë që ...

Lulzim Hasa . Unë jam me Silvanën në takimin që patëm me komisionin tonë ishte një person që është propozuar për çertifikatë mirënjohje.

Mukades Gixhari . Është propozuar nga komisioni?

Ervis Shera . Të jap një shpjegim të vogël.

Silvana Aliu . E jap unë shpjegimin e kemi marrë si nismë për të gjithë mësuesit pas vdekjes.

Ervis Shera . Në rregull meqë jemi në kuadrin e diskutimit sa të bëj një sqarim të vogël ...

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë pak sekretarin në lidhje me një informacion të vogël.



Ervis Shera . Kemi miratuar një rregullore për titujt e nderit që normalisht ju është përcjellë që titujt që jep këshilli janë “Qytetar Nderi” dhe “Mirënjohja e Qytetit” , “Çertifikata e Mirënjohjes “ është një titull që nuk është miratuar tek ajo rregullore, në rastin tonë mund t’i delegohet sektorit të kulturës që të marrë masat për dhënien e çertifikatës së mirënjohjes në varësi ku e di unë... por ne nuk mund të marrim dot vendim për diçka që se kemi ...

Enver Memolla . Atëherë kur të vijnë kërkesa për mësuesit mos të vijnë në këshill bashkiak por t’i jepen çertifikata mirënjohje sipas...

Ervis Shera . Të ja përcjellim sektorit të kulturës ...

Edison Memolla . Kjo pjesa e mësuesve është goxha e nismë e mirë edhe ana e... e të dy anëve politike unë do sugjeroja pastaj do e shikoni po ju me komisionet që keni, që mos ngeli vetëm për ato mbas vdekjes të jetë dhe para se të vdesin...

Alime Hoxha . Ata që janë në pension.

Edison Memolla . Kështu që në momentin që ato dalin në pension, kanë një karrierë po themi mbi 20 vjeçare në arsim, të bëhet një nismë kaq vite mësuesi doli në pension t’i jepet çertifikata e mirënjohjes mendoj unë edhe të jetë një vlerësim për të gjithë se nuk na nuk na kushton asgjë.

Lulzim Hasa . Ai formalitet është.

Edison Memolla . Formalitet për çdo mësues është edhe kënaqësi kur e sheh fëmija, prindi ka një çik kënaqësi në familje. Kështu që unë të sugjeroj që mos ngeli pas vdekjes, po të bie edhe më afër nuk kanë përfitim është përfitim moral që ti e vlerëson.

Indrit Dedej . Po të japësh diçka që ta ndjejë tamam.

Fatmira Thartori . Si ide është ide e mirë megjithatë ta shikojmë.

Indrit Dedej . Unë mbaj mend babën tim kur doli pension në kohën e Enverit i dhanë një radio Iliria, tani një dhuratë që e ndjen dhe ai që kënaqet.

Edison Memolla . Fillojmë me këtë sugjerim.

Silvana Aliu . Kur të jetë 7 Marsin mund të bësh dhe historikun e qytetit arsimit ...



Edison Memolla . Ne presim nga të gjithë propozimet nga ju dhe ne si bashki bëjmë listën edhe hajde për gjithë njësitë të dalim ...

Mukades Gixhari . Zonja Besnike ta dëgjojmë pak se nuk e kemi dëgjuar sot.

Besnik Coraj . Të njëjtën gjë do thoja dhe unë po pasi e tha edhe kryetari të bëheshin edhe para se të shkonin në...

Edison Memolla . Në momentin që dalin në pension të kalojë...

Besnike Coraj . Edhe nuk e di unë kam pasur mësues ka ngelur në memorien time një Polizoi Rajdho...se dëgjova këtë zotërinë nuk e mbaj mend shumë si ...e kam dëgjuar po them që për mua ishte një figurë goxha për t'u vlerësuar... nuk e di se si...

Indrit Dedej . Burri zysh Eli Rajdhos.

Besnik Coraj . Tani unë e mbaj mend si mësues Zoi.

Edison Memolla . Na i sillni të gjithë propozimet dhe vazhdojmë herë pas here...

Besnike Coraj . E ka nisur kjo unë nuk e di se kush i vu këto emra

Fatmira Thartori . Ka bërë kërkesë vetë familja e të ndjerit për të...

Indrit Dedej . Kurse qytetarët e nderit them një njeri që është kontribues për qytetin ai e meriton “Qytetar Nderi” se qytetarët e nderit mund të jenë të pakët dhe të vlerësiuar mendimi im. Mos bëjmë qytetar bderi se ne tani kemi dhe mësues debatikas që në kohën e Enverit janë shprehur kanë folur, janë dënuar mësues për fjalën e lirë edhe nuk mund t’i bëjmë ne të gjithë qytetar nderi, se ti mund ta dish se kush është.

Edison Memolla . Ju i diskutoni në komision kush e meriton të kalojë.

Indrit Dedej . Edhe diçka tjetër kam mos e nënvlerësoni komisionin e pastërtisë së figurave në Tiranë.

Edison Memolla . Apo jo Vis e kemi kusht këtë që ta dërgojmë tek komisioni i dosjeve.



Ervis Shera . Po.

Mukades Gixhari . Atëherë, Kalojmë në pikën 11, njoftim për gjetjet e barometrit në nivel kombëtar dhe specifikisht për bashkinë Rrogozhinë. Fjala për kryetaren e Aleancës së Grave Këshilltare znj. Fatmira Thartori.

Fatmira Thartori . Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Të nderuar përfaqësues të administratës,

Të nderuar qytetarë,

Nga të dhënat që ka dhënë barometri që është një instrument vlerësimi dhe monitorimi për zbatimin e standardeve të barazisë gjinore në qeverisjen vendore, dhe të dhënat për Rrogozhinën që janë mbledhur në muajin dhjetor 2024- janar 2025, në bashkëpunim të ngushtë midis Aleancës së Grave Këshilltare dhe administratës së bashkisë është arritur në përfundimin se në bashkinë tonë mungojnë strehëzat. Çfarë është strehëza?-Janë vende ku strehohen gratë ose vajzat e dhunuara. Nga analiza rezulton se Bashkia Rrogozhinë nuk ka të dhëna për strehëzat si shërbim i kujdesit shoqëror për gratë, vajzat shtatzëna, prind i vetëm apo viktimë të dhunës familjare.

Për sa më sipër, Aleanca e Grave Këshilltare, në përmbushje të rolit të saj si zë për barazinë dhe drejtësinë sociale në vendimmarrje, i rekomandon administratës së bashkisë që të mundësojë marrjen e masave konkrete për përmirësimin nismës së mësipërme duke filluar punën në vitin e ardhshëm dhe për të mundësuar ngritjen e një strehëze të tillë që i vjen në ndihmë të gjithë komunitetit nga ana sociale.

Gjithashtu, kërkojmë rregullisht një raport zyrtar nga administrata për ecurinë e përmbushjes së këtij detyrimi, në mënyrë që të mund të ndjekim progresin dhe të sigurohemi që parimet e barazisë gjinore të jenë të pranishme në qeverisjen vendore.

Barazia gjinore nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një themel i demokracisë lokale dhe zhvillimit të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Mukades Gixhari . Faleminderit zonja Fatmira. Po z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Për barazinë gjinore jemi duke përgatitur atë planin e barazisë gjinore që jua kam nisur në email, plani është trevjeçar. Planin e barazisë gjinore është tre vjeçar dhe domethënë fondi që është parashikuar është ai 9 milion lekë të vjetra për tre vite sepse ato mundësi financiare kemi dhe ne, që ta zbatojmë atë plan mos të bëjmë parashikime shumë të mëdha dhe mos zbatojmë asgjë. Sa bërë strehëzën ne i rekomandojmë në Tiranë të gjitha sepse është e pamundur që ne t'a mbajmë edhe sikur ta kemi strehëzën se strehëza do punonjë, do psikologë,



do infermierë është stafi që është e pamundur që ta mbajmë kështu që rastet e dhunës ne i ...

Silvana Aliu . Strehëza është e nevojshme të ndodhi një dhunë ku do e çosh në Tiranë? Ti e strehon merr një apartament dhe e mban për të strehuar të dhunuarin, nuk është nevoja të marrim staf se këtë e dimë që nuk e arrijmë kurrë, problemi është një strehë momentale.

Ledian Hasani . Faktikisht duhet një qendër multifunksionale jo vetëm për pjesën e grave.

Edison Memolla . Ne e kemi prioritet kështu që e kemi bërë një projekt të përgjithshëm edhe për njerëzit e pastrehë për një godinë...

Fatmira Thartori . Për një godinë qoftë dhe një shkollë që nuk është më funksionale.

Ledian Hasani . Do personin aty që t'i shërbejë, njerëzit e dhunuar duan personin aty.

Silvana Aliu . Për momentin një strehëz ne e kemi kërkuar në këtë mënyrë, në rast dhune të...

Ledian Hasani . Ne flasim mund ta parashikojmë tek plani që do bëjmë se e ndryshojmë planin vit për vit nuk është problem ajo pjesë. Faleminderit Ledio, faleminderit zonja kryetare. Vazhdojmë me pikën 13, Informacion mbi veprimtarinë dhe masat e marra nga Policia e ...

Silvana Aliu . Pikën 12, na e relato.

Mukades Gixhari . Ngaqë iku, dmth u kalua meqë iku ... atëherë shqyrtim i kërkesës për informacion nga anëtar i Këshillit Bashkiak z. Mitat Daja. Kemi një kërkesë për disa informacione të ardhura nga këshilltari z. Mitat Daja . Kryetari i bashkisë fjala për ju.

Edison Memolla . Pavarësisht se ne e kishim marrë përderisa personi vetë nuk është këtu, kishte bërë një kërkesë të përgjithshme, disa informacione janë edhe konfidenciale që nuk mund të jepen. Siç e thanë dhe kolegët këshilltarë më përpara thanë që janë ca pjesë punësimesh që nuk i takojnë këshillit bashkiak kanë dhënë apo jo dorheqjen. Ka kërkuar informacion mbi stadiumin mbi sport klub Egnatia, që të themi të drejtën është një nga privilegjet që ka Rrogozhina sot edhe ku njihemi në të gjithë botën. Normalisht ka ato situacionet e veta bashkia është edhe përgjegjëse edhe aksionere e kësaj 25% që i takon. Ka kërkuar nëse këto burime financiare po them në mënyrë të përgjithshme se i kishim menduar në mënyrë specifike por që ai s'do të dëgjojë por po e them. Në situacionet që ato mbajnë çdo ditë janë edhe online KF shoqëri aksionere Egnatia janë online, ka dalë me fitim minimal, bashkia Rrogozhinë nuk ka marrë të ardhura nga nga këto



tre vite sepse normalisht që të marrësh nga një biznes duhet edhe të shëndoshet ai biznes që të marri të ardhmen e tij. Të ardhurat që ne i kemi kaluar janë ato vendimet e këshillit bashkë që ne kemi marrë për sportin që i kanë kaluar shi Egnatias. Përfitimet e bashkisë në këtë rast po themi që nuk ka pasur deri më sot por kemi përfituar një stadium që do jetë aty për të gjithë vitet që do kalojnë, se nuk është se do e marri kush me vete. Kemi pasur po nga këshilltari në fjalë ka pasur propozim për pensionistët ku Egnatja shi ka marrë për pjesën e grave që është falas hyrja në stadium. Ne kemi pritur dhe ja kemi dërguar edhe si mendim për pjesën e kësaj për pensionistët që të hyjnë apo jo në stadium pa pagesë. Jemi në diskutim se do parë dhe kjo punë dhe sporti me ato të ardhura do mbahet. Pastaj ka bërë kërkesë për pjesën e... Kemi pasur shumë jemi është kemi bërë kemi pasur ato kontakte dhe është pozitiv te kjo pjesë që të dëgjojë çdo gjë nga ajo që ju do kërkon. Përsa i përket pjesës, për pjesën e pastrimit normalisht kemi një informacion është janë likuuar nga granti rreth 45 milion dhe nga shpenzimet nga të ardhurat 14 milion deri në shtator të vitit që ne jemi. Kemi muaj që janë brenda që akoma nuk janë alokuar nga bashkia, janë dy firma që e bëjnë pastrimin që e dini. Një merret me gjelbërimin, një merret me pastrimin, shumat janë pagesat çfarë bëhen nga bashkia Rrogozhinë online si pagesat, si kontrata, si dhe sa është pagesat mujore nuk kemi çfarë të fshehim, këto gjëra unë s' kuptoj ndonjëherë dhe pyetjet që bëhen për këto gjëra se i keni aty nuk është se... unë e kuptoj që duan për shoë mediatik ne jse i kuptojmë këto pyetje ... operatorët ekonomikë që kryejnë këtë shërbim jua thashë që janë dy firma që merren, një merret me pastrimin, një merret me gjelbërim, pastrim. Ka sjellë dhe një pyetje të katërt informacion mbi problematikat që ka sjellë dhe ndërmarrja ujësjellës kanalizime në qytetin e Rrogozhinës që janë për rrugët që ato herë pas here veprojnë ku ne i kemi çuar një notë vërejtje dhe ndoshta mund të marrim dhe veprime të tjera gjëra sepse kanë hapur disa vende edhe pa leje dhe me të drejta kanë ngrejtur pyetjen. Kështu që pak a shumë këto janë të përgjithshmet. Nëse ke ndonjë pyetje konkrete nga ju që jeni se nga ky që ka bërë iku, unë jam i gatshëm që t'ju përgjigjem.

Mukades Gixhari . Po zonja Silvana.

Silvana Aliu . Përveç varrezave të qytetit janë dhe dy varreza në lagje tek Gjuztë dhe tek Shimtë. A ka të drejtë firma të ndërhyjë për pastrim?

Edison Memolla . Atëherë firma ka të drejtë sepse janë nuk e di në kontratë 12 a 10 a 8 nuk e di diçka të tillë varrezat kryesore të njësive, do hap kontratën dhe të kthej përgjigje të saktë. Kështu që nuk është problemi ... patjetër patjetër aty ku nuk ndërhyjnë që e kanë ato detyrim ndërhyjmë ne që kemi rreth 30 e kusur varreza që janë nëpër njësi . Kështu që prit se ka bërë dhe një informacion tjetër për pjesën e tregut më ku e lexova unë këtë pjesën e tregut për pjesën e tregut pastaj e keni përgjigjen kështu që e keni atë informacion po unë do të dal edhe ky tregu i qytetit



që ne kemi bërë se shumë zhurmë është bërë me këtë tregun por do të themi që ato janë 23 tezga të tilla aty janë vendosur 10 apo 11 të tjerat janë në magazinë që do përdoren në Spille, në Gosë, ku ka kërkesë. Kështu që janë aty brenda mund të verifikohen, mund të shikohen, mund të bëhen preventiva në firma të ndryshme, mund t'i gjykoni të gjitha se shumë tym është hedhur aty dhe 10 tezga kaq lekë, kaq milion, kaq s'po bëjnë këto milion aty. Po nëse ju gjeni më lirë ne hajde t'i bëjmë. Ato kanë një manual që Silvanë ti e di shumë mirë që është manuali, merrni manualin e shikojeni nëse bashkia ka bërë shkelje ne jemi të gatshëm se edhe unë pa kam bërë shkoj te vendi, kështu që jemi të gatshëm që të jemi transparent të vini t'i shikoni tek magazina ...

Silvana Aliu . Anëtar i këshillit më intereson... të sqaroj për punësimin ne si këshill nuk kemi të drejtë të kërkojmë ... se shpesh na bëhet nëpër rrjete sociale nuk ndërhyeni nuk bëni në qoftë se bëni kërkesa për shoë atëherë unë jam e para si opozitë të them që po unë dua listën e punëtorëve dhe të gjithë, nuk e kemi këtë të drejtë vetëm kaq të sqaroj njëherë e mirë se deri ku e kemi ne atë...

Mukades Gixhari . Faleminderit. Të dëgjojmë pak zonja Alime.

Alime Hoxha . Jo, unë isha tek kjo pjesa e pastrimit me thënë të drejtën pastrimi në Rrogozhinë ka çaluar.

Edison Memolla . Tani unë po e flas ne e dimë që ka çaluar, kemi marrë dhe nota proteste përtej saj sepse ka ndodhur herë pas here nuk është faj vetëm i bashkisë tonë dhe janë sepse janë disa gjëra që ne i çojmë në Elbasan këto.

Alime Hoxha . Është dhe problemi i koshave që ata mbushen që në mëngjes me ato kartonat e tyre të supermarkeve.

Edison Memolla . Këtë e kemi çuar shkresë do marrim gjoba më fal të ndërpres një minutë pastaj edhe një gjë duhet ta ngrejmë të gjithë së bashku sepse unë edhe ju shikoni koshat janë bosh dhe siç e kemi ne zakon shkojmë aty te koshi dhe derdhim karrocën apo hedhim koshat përjashtë. Mendoj që duhet të sensibilizojmë të gjithë ato njerëzit që ne njohim se nuk mund t'i detyrojmë ne kemi marrë dhe gjoba por nuk është kjo mënyra më e mirë edhe një pjesë më e madhe të koshave ndodh kjo pjesë. Kurse për pjesën e bizneseve ne i kemi çuar edhe shkresë edhe orarin që ato duhet të dalin sepse gjithmonë pastrimi ndodh në një orar të vonë të darkës që ato të dalin t'i hedhin në mëngjes. Kështu që e kam marrë besoj që ka qenë dhe nga mbledhja e kaluar e njëjta pyetje apo diçka më përpara për këtë pjesë. Kështu që jemi okej te kjo pjesë dhe kemi marrë masat që ne na takojnë. Më fal që të ndërpreva zysha.



Alime Hoxha . Jo s'ka gjë unë këtë kisha për pjesën e pastrimit pastaj të tjera do flasim po meqë ishim këtu te pastrimi që ka çaluar.

Indrit Dedej . Për punën e biznesit unë nuk di që bizneset nuk kanë punë fare tek koshat ose kanë pagesë ekstra ose i gjejnë vendin, unë kështu e di.

Edison Memolla . Jo, ata kanë paketë fiskale kanë një pagesë më shumë nga qytetarët por ne jemi kemi se janë biznese nuk janë aq që po themi që janë të mëdhaja që duhen koshat e veçantë edhe nuk kanë këto produktet që janë që duhen kastile për t'i zbaltuar nëpër nëpër institucione të tjera sepse ka nëse një prodhon bojë apo çfarë ne nuk mund ta hedhim në kosh të plehrave se duhet ta marri koshin e vet. Kështu që ata kanë një pagesë mbi nuk e di se është nga paketa fiskale dhe kanë orar po i kemi caktuar orarin si supermarketet që janë në Rrogozhinë. Në Spille gjatë verës ju e keni parë pastrohet dy apo tre herë në ditë pjesa e plazhit.

Silvana Aliu . Prap duhet të jemi koshientë që qyteti herë pas here mbetet...

Edison Memolla . Nuk po them që jemi xixë dhe është pasqyrë... është i drejtë shqetësimi.

Mukades Gixhari . Atëherë i rikthehem pikës gjashtë që e kaluam se tani na erdhi...raport nga njësia e auditit të brendshëm mbi punën e bërë dhe problematikat e evidentuara në bashkinë Rrogozhinë përgjegjësi i njësisë së auditit të brendshëm z. Nuredin Tosku.

Nuredin Tosku . Përsëritje! Ju kam dërguar të gjithë informacionin e fundit të punës së auditit të brendshëm për vitin 2025. Në qoftë se keni diçka...

Mukades Gixhari . Informacionin e keni të gjithë nëse keni ndonjë pyetje rreth kësaj pike.

Indrit Dedej . Kur të mbarojë kontrolli i shtetit të na sillni dhe ne...

Nuredin Tosku , Kontrolli i shtetit ka ardhur dy herë është herë, ne e kemi dhe në informacion.

Indrit Dedej . Se ti je i shtëpisë , kontrolli shtetit të ka sjellë ty.

Nuredin Tosku . Ne i kemi bërë katër auditime domethënë në qoftë se do të referojë dhe të gjitha gjetjet rekomandimet rezultatet, Po kemi dy njësi Gosë dhe Sinaballaj kemi dhe drejtorinë politikave urbane, kemi dhe drejtorinë e shërbimeve, i kemi bërë të gjitha patjetër janë auditime të përfunduara. Kemi krijuar auditim në drejtorinë e shërbimeve marrim një rast ose në drejtorinë



e politikave urbane. Kemi lënë një rekomandim, po për planet mujore të punës dhe vjetore, programimet që bëhen, ky është një rekomandim i parë. Kemi rekomandim lidhur me raportet dhe evidencat që për investimet e kryera në fushën e ndriçimit rrugor azhurnimit të gjendjes që bëhen por thjesht kemi kërkuar për dokumentacion.

Enver Memolla . Vetëm një gabim ke bërë ti, ke ardhur pa llokume.

Nuredin Tosku . Atëherë në shkresën 2410 është dërguar plani strategjik që dërgojmë ne në dhjetor Ministrisë së Financave lidhur me punën tonë që ne kryejmë, trevjeçarin dhe njëvjeçarin. Në planin vjetor të 2025 kemi vendosur prioritetet fushat me risk të lartë për t'u adituar, të cilat bëhet një vlerësim nga nga njësia auditit për ndikimin e këtyre fushave. Atëherë kemi kryer katër auditime të plota, aktualisht jemi në auditimin e drejtorsë së financës. Sapo e kemi mbyllur dokumentacion kemi akoma dhe përfundimet për të dërguar dhe parashikojmë që për vitin 2025 të kryhen pesë auditime. Akoma s'ka mbaruar, parashikimi në fund ne e mbyllim në dhjetor me 31 dhjetor mbaron programi jonë. 60% të planit vjetor të gjithë planet. Mbi auditimin e kryer në drejtorinë e politikë urbane me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së subjektit të udhëtuar duke respektuar të gjitha normat rregulatore në fuqi komfort të planit vjetor të auditit të brendshëm është kryer dhe auditimi të drejtë politikë urbane. Lidhur me zhvillimin e aktivitetit të saj konfort ligjit dhe të gjitha rregullave në fuqi. Në këtë drejtori nga audituesit u konstatuan parregullësi të karakterit organizativ kryesisht tre gjetje dhe një gjetje karakterit me dëm ekonomik e cila rrjedh si pasojë e keqlllogaritjes së taksës së ndikimit infrastrukturë nga ana e specialistëve, gjetje e pranuar po nga stafi si dhe u morën masa për korrigimin e njoftim detyrimit për efekt llogaritjen gabim të taksës së ndikimit në infrastrukturë. Kemi marrë dhe njësitë administrative Gosë, Sinaballaj ku janë konstatuar janë konstatuar gjërat kryesisht të borxhit më tepër familjarët, e cila është një problematikë në bashkinë tonë.

Silvana Aliu . Atëherë më të përmbledhur na duhet në fund të dhjetorit.

Nuredin Tosku . Po patjetër.

Mukades Gixhari . Faleminderit vazhdojmë me pikën 13 , Informacion mbi veprimtarinë dhe masat e marra nga Policia e Shtetit për menaxhimin e situatës së zjarreve që prekën Bashkinë Rrogozhinë në stinën e verës 2025. E kemi njoftuar postën e policisë, ja kemi dërguar njoftimin zyrtar dhe nuk na ka ardhur asnjë përfaqësues.

Edison Memolla . A ka sjellë raport?



Mukades Gixhari . Jo edhe mbledhjen e herës së kaluar i kemi dërguar, po po me të gjitha. Kalojmë. në pikën 14, raport nga administratorët e njësive administrative mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikët e hasura gjatë periudhës qershor- tetor 2025. Me sa po shikojmë në sallë...

Edison Memolla . Jo i kam marrë unë se ju e dini që është periudhë shirash...

Mukades Gixhari . Ka ardhur vetëm një përfaqësues nga Njësia Administrative Lekaj Bashkim Greca.

Edison Memolla . Ska gjë flas unë këto tjerat kurse Lekaj...

Bashkim Greca . Ne e kemi sjellë dhe si material.

Edison Memolla . Atëherë unë po e marr nga pjesa e Kryevidhit që është më e largët qershori ka qenë pjesë ku edhe Kryevidhi ka qenë një nga njësitë që ka hyrjet më të mëdhaja dhe nga pjesa e pushuesve që shkojnë në plazh. Normalisht edhe të ardhurat e tyre kanë qenë goxha të mira, pastrimi ka qenë një nga pikat kyçe që edhe ne na ka funksionuar me sistemin e rrugës së re që është bërë atje nëse ju keni kaluar që është lidhur nga vila deri në Spille tek Guri i lëmuar, që ka ndryshuar komplet rrjedhën e gjithë situatës atje duke rritur vlerën e pronës e të tjerë. Njësitë Administrative kanë bërë pastrime kanalesh në bordin e kullimit është mbaruar edhe hidrovori që ka qenë një problematikë me vete në këtë zonë. Kështu që kjo zonë është sistemuar të paktën për pjesën e përmbytjeve ku edhe e thamë në këtë rast që nga shirat ka qenë zonë që u përmbyste është pa probleme deri tani. Shpresojmë që ta kalojmë pa probleme deri në fund të të shirave. Për pjesën e njësive Gosë është informacion e them në mënyrë të përgjithshme nëse keni pyetje pastaj kalojmë për detaje. Njësia e Gosë ka qenë një nga zonat që u përmbys më shumë nga shirat. Faktikisht kjo ka qenë qershori, tetori kemi bërë edhe pjesën e pastrime kanalesh.

Enver Memolla . Kryetar më fal të ndërpres pak. Për Kryevidhin problematika thotë është e domosdoshme shtimi i këtyre pozicioneve për taksat dy punonjës, një përgjegjës, një specialist dhe një jurist pasi ka problematika të shkresave juridike.

Edison Memolla . Po është e vërtetë.

Enver Memolla . Dhe ndarja e pozicionit të arkivistit nga sekretar në protokoll.

Edison Memolla . Kjo është një njësi që pothuajse ka ngarkesën e gjatë verës siç e ka bashkia.



Ne kemi pasur edhe me burimet njerëzore jemi duke rishikuar pjesën e strukturës kështu që është e domosdoshme.

Enver Memolla . Jemi në prag të miratimit të strukturës.

Edison Memolla . Jo, ne do jemi po tek numri i njëjtë.

Alime Hoxha . Jo po i them Silvanës, se Silvana thotë ne kemi marrë vesh kush do shkojë. Ju i merrni vesh të gjitha dhe ne nuk e dimë këtu.

Edison Memolla . Nuk e dimë ne që e kemi ... këto i dinë të gjitha. Ju po më leni se ne e dimë Ka kërkuar dhe është e vërtetë dhe është e domosdoshme nuk po themi të gjitha po një ekonomist dhe një jurist duhet. Ne do mundohemi i njëjti numër por duke bërë modifikimin e duhur të strukturës.

Edison Memolla . Po e kemi marrë është Spilleja dhe Rrogozhina që ne po i marrim për shpronësim. Spilleja është në Rreth Greth janë varrezat.

Lulzim Hasa . Janë tre fshatra.

Edison Memolla . Është rreth grethi është Rrogozhina që po shkojnë në limitet e kësaj kështu që jemi duke u marrë me këtë pjesë. Për pjesën e Lekajt do flasi vetë...

Bashkim Greca . Bazuar në shkresën tuaj Nr.4340.Prot datë 21.10.2025 lidhur me raportim në këshillin bashkiak të mbarëvajtjes së punëve dhe problematikat e hasura gjatë periudhës qershor-tetor 2025 ju raportojmë si më poshtë:

Gjatë kësaj periudhe NJ.A Lekaj ka kryer dhe mbetet për të kryer një sërë punësh: 1. Një punë e mirë për periudhën qershor tetor 2025 është bërë sidomos me vaditje të kryera nga fermerët për tokat e mbjella me kulturat e tyre bujqësore. Në zonën e poshtme në fshatrat Shkozë, Luzi Madh dhe Lekaj pavarësisht të ndonjë problematike në fillim të sezonit vaditjes me kanalin e madh Peqin- Kavajë u arrit që punët e vaditjes të kryeshin normalisht në këto fshatra, një punë e shkëlqyer u bë sidomos në zonën e sipërme për vaditjen në tokat në fshatrat Okshtun dhe Gërmej të cilët vaditen pa asnjë lloj problemi sa deshëm kur e deshëm ujin e vaditjes.

Edison Memolla . Do i them unë dy tre problematika që kanë problematika në dy tre zonat zonës e Gërmejit që është pjesa e lugut që i thonë .. ne kemi bërë një projekt e kemi dërkuar atë



ministrisë së bujqësisë dhe shpresojmë që të dalim fitues tek ajo pjesë. Pastaj është edhe një problematikë me pjesën e pjesën e ujëmbledhëit që kemi atje u sistemua dhe portat janë të dyja funksionale. Porta është çdo gjë në rregull është filluar të mbushet të rezervuari me shirat të gjithë shirat i kanë... kështu që jemi ok me pjesë edhe kjo ishte problematikat më kryesore më e madhe, kështu që arritëm me sukses dhe është çdo gjë në funksionon. Pastaj problematikat janë të shumta flasim për infrastrukturë rrugore, ndriçim. Edhe ujëmbledhëset kur bëhen kanë një afat të caktuar kohor se sa e kanë jetën nuk është se nuk e pastron njëri se duhen fonde të paparë kështu që... të paktën të jetë një menaxhim i mirë vitet e fundit kemi pasur menaxhim dhe ka tepruar, këtë vit që u hapën për t'i rregulluar, mendojmë me shirat që do vijnë besoj do mbushet në nivelet e duhuara, e kalon të paktën aq sa...

Bashkim Greca . Biles deri tani ka një mbushje speciale kur kam qenë pardje.

Saimir Cani . Është një problem tjetër që është burim aksidenti tek kryqëzimi aty tek Haqimi.

Bashkim Greca . Po.

Edison Memolla . Mbaje shënim.

Saimir Cani . Edhe ajo që është bërë ai aksidenti tek repati që është ajo që kadalës si shkurre.

Edison Memolla . Kemi provuar por janë shumë nuk kemi dhomë aq të madh, se në të gjithë botën ndodhin këto tragjedi që bëhen, ne aty thjeshtë kemi folur edhe me administratorin dhe me specialistët që mos kalojnë kamionët e mëdhenj të paktën në ato orar që bëhen... po janë familje aty që do kalojnë se lidhet edhe Lekaj në rrugën dytësore kurse për kamionët kemi marrë masë kemi dhe policinë bashkiake që mos mos kalojmë aty me ato tre katër orë. Se është gjithë nëse kalon gjithë Europën i ka këto tregjet e atillë.

Silvana Aliu . Të merren masat sepse këtë vit në Spille ka qenë shumë problematike.

Edison Memolla . Kanalizimi dhe ujërat e zeza në Spille ka dalë fituesi i që do bëhen ujërat e zeza, por kanë ato kohët e veta që do të marrin lejen mjedisore më tej që kanë ato studimet e natyrës se çfarë ka nga mjedisi dhe është fond që është i miratuar që duhet të fillojë sa më shpejt kështu që është programuar gjatë kohës normale diku te 7- 8.000 banorë që do jenë prezent gjatë verës do jetë në funksion për 20.000 banorë, kështu që është një sistem që shpresoj që të na të na nxjerri njëherë e mirë nga ajo.



Silvana Aliu . Dhe një gjë tjetër kisha për çerdhen e fëmijë në qtetin e Rrogozhinës nuk duket e përshtatshme për aq fëmijë sa janë aty lagështi.

Edison Memolla . Lagështi nuk e di por hapësira po jemi dakord kemi parë shumë ndërtesa por nuk përshtatet sepse duhet dhe nëse ne ikim nga aty duhet të ketë një po themi dhe një herë më e madhe se aq sa është nuk ja vlen. Edhe me e kaluar me drekë nuk kemi gjetur një godinë që të jetë afër qendrës sepse ne i çojmë diku tjetër besoj që nuk do jetë... kemi pyetur aty mbas bashkisë që është një ndërtesë, e kemi parë, kemi bërë një projekt me personin, por dhe duhet të vish për një afat edhe të gjatë kur ta marrësh me qera, se të bësh një investim, pastaj të ikësh vitin tjetër. Kështu që ne kemi parë vende të përshtatshme, por nuk kemi gjetur një gjë që t'i shkojë përshtat dhe fëmijëve. Edhe kopshtin kemi pasur dhe bisedime edhe me drejtoritë edhe me edukatorët edhe me mësues që të kalohet edhe ajo me drekë sepse ju ndihmon të gjithëve. Po nëse nuk lëvizin çerdhja nga aty, nuk kemi hapësira që të bëjmë kopshtin me drekë.

Silvana Aliu . Një pyetje kisha unë për drejtorin e arsimit, janë pajisur kopshtet me materiale?

Orges Tosku . Çfarë materiali?

Silvana Aliu . Materiale... për pastrim.

Alime Hoxha . Mjete didaktike.

Edison Memolla . Edhe pjesa e taksës që ju miratuar për këtë punë është që të shkojë atje ku duhet investimi.

Indrit Dedej . Kryetare kisha diçka për drejtorin e bujqësisë për Shkumbinin lejohet tani me e shfrytëzuar ...

Edison Memolla . Ta shpjegoj unë drejtori nga publiku kështu se e pashë , ne si bashki kemi çuar dy nga këto punuesit që i kemi parë të tregoj se e kam parasys çfarë po thua... gjërmimin e pa kriter a me kriter të lumenjve. Të tregoj nuk kërkohet ndihmë një shkelje ligj atëherë ato që kanë shkelur ligjin po të dini janë dërguar për në prokurori janë në hetim për shkeljen e tyre ato lumi shkumbin është nuk është pronë e bashkisë është pronë e Ministrisë së Bujqësisë që varet nga një IKMT tjetër. Ne kemi dërguar shkresën po të doni jua vejmë në dispozicion që ne i kemi bërë të gjithë hapat tona që kush bën dëme të tilla ... Janë po të themi që janë të dy që janë brenda territorit tonë, disa nuk janë territorin tonë ja kemi dërguar kanë shkuar për ndjekje penale.



Fatmira Thartori . Në moment që ato kanë shkuar në prokurori, pra çështja ka shkuar në prokurori është prokuroria ...

Indrit Dedej . Në momentin që del një kamion tek rruga që unë e administroj nuk ka shans tani ka diçka

Edison Memolla . Janë ndjekur të gjitha hallkat ligjore kështu që...

Fatmira Thartori . Nuk është pjesë më e jona... është prokuroria...

Edison Memolla . Indrit mos e kthejmë në bashkëbisedim po të doni ju jap dhe shkresat që janë bërë janë bërë të gjitha të paktën për ato që janë brenda territorit tonë.

Fatmira Thartori . Prap unë nuk jam kundër marrjes së masave, ai po shfrytëzohet pa kriter po ashtu të merren masa, ne jemi për ligjin për zbatimin e ligjit.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën 15 tek të ndryshmet. Kërkesë nga zoti Endri Demarku, kryetari i Këshillit Vendor Rinor, Bashkia Rrogozhinë. Për këtë pikë është diskutuar dhe në komisionet e këshillit të mbledhur dje. Domethënë në qoftë se e don fjalën ndonjë në lidhje me kërkesën...

Edison Memolla . Nuk e di çfarë keni vendosur tek komisioni por është një kënaqësi për nxënësit në ekselentë. Është bërë një kërkesë që të merret shpërblim me një notë të caktuar nuk e di ku do qëndroj kush quhet ekselentë jeni ju që do e ndani edhe nëse do ishte e mundur do bëhet në buxhetin e ri të ishte një zë kemi bërë një parashikim dhe të kalonte për ndihmesë duke parë dhe rritjen e çmimeve për studentët qeratë e gjitha me radhë librat që do blejnë. Për më shumë po ja kalojmë Endrit që t' jua shpjegojë.

Endri Demarku . Atëherë përshëndetje që të gjithëve! Pas mbledhje së fundit që ne si të rinj bëmë me Këshillin vendor rinor të bashkisë Rrogozhinë dhe një bashkëbisedim me kryetarin e bashkisë zotin Edison Memolla dolëm në një konkluzion që një mbështetje e madhe për arsimin më cilësor dhe për një mbështetje financiarisht për të gjithë studentët por edhe për nxënësit ekselentë të gjimnazeve do të ishte shumë mirë një pjesë burse e parashikuar nga miratimi i buxhetit për bashkinë e Rrogozhinës për vitin e ardhshëm. Mbështetja financiare më duket një ndihmë goxha e konsiderueshme për të gjithë nxënësit apo dhe studentët pasi mund të them se të gjithë mund të jemi koshentë për pjesën e shpenzimeve apo jetesës së kushtueshme që një studenti i duhet hasur në studimet e larta qoftë dhe në Tiranë apo dhe në qytete të tjera. Pastaj për



sa i përket arsimit të mesëm gjimnazeve, do të ishte mirë që edhe për nxënësit ekselentë në gjimnaze të kishte një farë vlerësimi për të gjithë ata që mund të dilshin me një mesatare, nuk po them 10.0, por 9.8 deri në mesataren 10. Ndërsa për studentët propozimi ishte që studentët me mesataren mbi nëntë që të dhënat janë dhe në zyrën arsimore të Rrogozhinës, nuk besoj se mund të jenë shumë studentë që kanë dalë mbi këtë mesatare dhe pjesa e bursës të fillonte të parashtrohej nga rezultatet e fundit të vitit shkollor 2024-2025. Pra ata që kanë dalë nga gjimnazi, që kanë mbaruar shkollën e mesme, por edhe ata që vazhdojnë shkollën e mesme pas këtij viti. Ky është si tip propozimi, tani nuk e di.

Alime Hoxha . Unë kam një pyetje para për komisionin se ne e kemi diskutuar këtë komisionin. Endri thotë që për nxënësit nga 2024 po flas për studentët jo për gjimnazistët me mesatare mbi 9 ne jemi dakort që kanë mbaruar gjimnazin me mesatare mbi 9, po në vit dytë kur të shkojnë këta nxënësit këta studentët si do procedohet ky bursë apo do jetë vetëm për rritjen e parë?

Endri Demarku . Jo, ideja është në qoftë se ai student e mbron mesataren në fakultet me mesataren mbi 9, të vazhdojë të vlerësohet nga ana e bursës, sepse ekselencia është e vazhdueshme, nuk besoj se...

Alime Hoxha . Dakord, ka dhe një gjë tjetër se nxënësit ekselentë ato që kanë mesatare mbi nëntë mbështeten me busa nga universiteti...

Endri Demarku . Po jam i njoftuar për këtë unë personalisht...

Alime Hoxha se dimë nëse ka bazë ligjore që ne si bashki t'i mbështesim ...?

Endri Demarku . Kjo do ishte një pyetje që doja të ja parashtroja edhe juve, por fakti që bursa unë jam vetë përfitues i asaj burse me meatare mbi nëntë dhe është 10.000 lekë të reja në muaj ose 100.000 lekë të vjetra. Tani duke e ditur, po shumë mirë duke e ditur shumë mirë se çfarë shpenzimesh ka mesatarisht...

Silvana Aliu . Shpenzimet janë njësoj për fëmijët ...

Endri Demarku . Unë jam shumë dakort por një nxënës ekselent jo, ideja është kjo një nxënës ekselent që ka punuar 12 vite në arsim nuk është njëlloj me një nxënës tjetër që thjesht nuk është munduar fare për të marrë notat dhe është me një mesatare poshtë nëntës. Vlerësimi vjen në bazë të mundimit, nuk besoj se vjen në bazë të mundësive financiare apo çfarë lloj gjëje tjetër.



Alime Hoxha . Jam dakort se për të nxitur nxënësit është gjë e mirë, po nuk e di a e kemi ne bazën për t'i nxitur nxënësit që të mësojnë dhe ata që kanë mesatare mbi nëntë...

Edison Memolla . Kjo është projektim nuk është vendim për t'u marrë sot ne jemi diskutim.

Alime Hoxha . Dakord dhe unë për diskutim po e hedh se nuk po diskutojmë që mora vendim por ka dhe një gjë tjetër se në projektbuxhetin e 2026 ne nuk mund të parashikojmë për këto që janë mbyllur.

Edison Memolla . Ne do kemi një numër që kemi limit nuk besoj nëse po flasim këta do them ne kemi mundësi 10 studentë që t'i shikojmë. Këto 10 studentë do jenë me mesatare më të lartë... marrim shembull.

Alime Hoxha . Më i madh se 10 mund të jetë, duhet të jetë diku tek 20 këto që janë mesatare mbi nëntë të paktën për këtë vit që është mbyllur. Po flasim që kjo do hyjë vetëm për këta që janë vit të parë, se ti në qoftë se do ta bëjmë këtë nismë duhet ta bëjmë vetëm për ata që janë vit të dytë që janë vit të tretë dhe ato e kanë pavarësisht se nuk e kanë marrë nga bashkia, por ato e kanë ruajtur mesataren, duhet t'ia bëjmë të gjithëve këtë, jo vetëm këtyre që janë viti i parë.

Edison Memolla . Hajde e diskutojmë o do e vendosim vetëm për vitin e parë, nëse do vazhdojmë për të gjithë vitet do jetë, sepse kjo do akumulohet çdo vit kemi 20 e 20 e 20 bëhen shumë ndoshta mbas pesë vitesh.

Alime Hoxha . Prandaj po them pra që kjo është diçka që...

Edison Memolla . Hajde kjo është diskutim prandaj jemi sot që të diskutojmë.

Alime Hoxha . Ne si vendim e lamë këtu për ta shqyrtuar që nuk ... pastaj për gjimnazet meqënëse jemi po tek kjo pjesa keni vënë dhe një këtu ndërkohë për nxënësit e gjimnazeve mesatarja mbi 9.8 propozojmë një bursë me vlerë 5.000 lekë të reja në muaj. Ne kishim një propozim si këshill që ne jo të japim mujore si komision më fal, në mbledhjen që ishte, por që në fund të vitit japim një shpërblim nxënësve që janë me rezultatet më të larta dhe këtë e menduam për nxënësit e klasave të 12-ta dhe të klasave të nënta. Ky ishte propozimi i komisionit dje.

Edison Memolla . Ne si bashki ti reflektojmë në projektbuxhetin e ri, nëse keni propozime të tjera hajde t'i shqyrtojmë.



Fatmira Thartori . Atëherë më fal që po ndërhyj për klasat e 12-ta dhe të nënta për shkak të buxhetit të paktë apo sepse ne nuk duhet t'i inkurajojmë ato të tjerët ...

Alime Hoxha . Nuk është puna se nuk duam t'i inkurajojmë por na shkojnë shumë.

Fatmira Thartori . Pra edhe njëherë pyetja do ishte pse për këto kufizime pra për të nëntën dhe të 12-ënn dhe jo për të gjithë pra duke filluar nga e nënta deri tek...

Alime Hoxha . Sepse shkojnë shumë.

Edison Memolla . Atëherë kryetar e ke domethënë ndjehesh rehat po përdor fjalën që të japësh 100.000 lekë muaj për muaj personit studentëve dhe atyre që merren asistencë t'i japësh 50.000 lekë që kanë familje?

Edison Memolla . Ne po flasim këtu jemi ulur për të diskutuar sepse kush ka... mundësia ekonomike është gjë tjetër ekselenti është gjë tjetër. Tani hajde të ulemi, bëjmë një mendim për të përgjithshëm edhe ta çojmë në projektvendim. Është një mendim nuk po shkojmë që po ja japim, tani besoj që duhen vlerësuar nëse duam të kemi njerëz në Rrogozhinë pa punë nesër.

Mukades Gixhari . z. Enver Memolla .

Enver Memolla . Kryetare faleminderit. Tani unë edhe dje edhe dje e lexova këtë shkresë më saktë pjesën e Endrit dhe këtu ka me të vërtetë dhe dje u diskutua që ka dhe një handicap ligjor.

Endri Demarku . Këtë vit kam marrë kështu që këtu e ngrejta propozimin, tani në qoftë se bëhet do jetë e mira për ne nuk ka dallime partiake në mes të kësaj gjëje. Unë nuk e di tani, në qoftë se ti ose çdokush nuk po them ti ke një fëmijë ekselent ose është ekselente do marri pjesën e bursës. Nuk të paragjykon njeri se je me këtë parti apo me atë parti nuk ka lidhje.

Enver Memolla . Siç po thoja e lexova dhe dje dhe në besimin e parë është një gjë e mirë por nëse do ti futemi procedurave ka diçka që nuk shkon dhe nga ana ligjore që dje kishim dhe një përplasje dhe përplasje nis tek studentët. Sepse me VKM ke studentët që kanë ndihmë ekonomike që janë trajtuar trajtohen me ndihmë ekonomike dhe studentët ekselentës paguhën me bursë nga Ministria e Arsimit. Që do të thoshte nëse do të bie dhe një tjetër bursë nga Këshilli bashkiak nga bashkia Rrogozhinë , ka një mbivendosje burse dy bursa për një fëmijë dhe pyetja që lind është, fondi sa mund të shkojë se ende nuk e di sa është fondi i bashkisë? Po flas për pjesën e fondeve sepse kemi dy gjimnaze kemi dhe shumë shkolla nëntëvjeçare përpos shkollën



fillore dhe kjo për mendimin tim, mendimi është personal nuk besoj se është e mundur të futen në këtë projektbuxhet derisa të bëhet taman një rivlerësim i të gjithë situatës, vlerësimi sa nxënës janë, sa e përfitojnë dhe sa duhet të jetë fondi që bashkia Rrogozhinë duhet të nxjerri nga arka e vet që të flasim për këtë pjesë sepse flasim për infrastrukturë arsimore që mungojnë nga të vegjlit dhe mos nxjerrim lehtë për të mbivendosur një të dytë për studentët. Dje në mbledhjen e komisionit të ekonomisë u vendos që po, siç është bërë para dy vitesh mos gaboja ja thashë dhe drejtoreshës që për nxënësit ekselentë të bëhet një dhuratë simbolike si për festën apo në fund të sezonit shkollor për të krijuar edhe brezin e mëposhtme që kush del më mirë të marri diçka kur shkon më lart. Por unë e kam më shumë te pjesa e ekonomisë sa fond mund të nxjerri bashkia kur ka mungesë të institucioneve për arsimin parashkollor që do të thotë nëse akumulon shumë fond mund të bësh atë që mund të bësh më mirë për pjesën tjetër si ide shumë e mirë. Po këtë pjesën nga ligjore e thashë dhe dje administratës që ligjërisht duhet ta shikoni me vëmendje këtë pjesë dhe thashë kjo shkresë t'i shkojë drejtorisë arsimore ta llogjikojnë me financën me zyrën juridike me të gjithë dhe pastaj nëse dalin konkluzionet këshilli këtu është por çfarë thashë për këtë besoj për këtë buxhet besoj se është shumë vonë që ka ardhur kjo shkresë.

Edison Memolla . Jo nuk është vonë atëherë të shpjegoj diçka, jemi dakort me ato që do merrni vendim, kjo është marrë një iniciativë e kemi nisur dhe vite të tjera, kemi shkuar deri në një farë vendi dhe nuk jemi këtu që të shkelim as ligjin as të diskriminojmë familjet disa t'i shikojmë. Ne jemi këtu që ta hedhim në diskutim bashkarisht të dalim me një konkluzion nuk është se kjo që themi ne mund të jetë me ne. Tani besoj që jemi të gjithë për shembull kemi kush ka fëmijë, kush ka mbesë, kush ka motër apo vëlla, ta shikojmë jemi në kohë që ta reflektojmë në buxhet nëse ne marrim mendim shpejt, por ky ishte hapi i parë që ta shikojmë kërkesë këtë pjesë që ta kthejmë projektvendim apo nuk e mendoni?

Enver Memolla . Unë sapo ta thashë kërkesën është ja drejtojmë ta shqyrtojnë dhe ta sjellin.

Edison Memolla Janë 20 nxënës, janë 10 nxënës shuma është kaq dhe do vlerësohen kaq njerëz. Nëse ju mendoni që edhe për ato që kanë ndihma ekonomike dalin me bursë, hajde t'i shikojmë. Sa është kosto? Kjo ishte jeni ju dakord që t'i hyjmë kësaj iniciative?

Silvana Aliu . Nëse kryetar sheh familjen në nevojë që kanë nxënës ekselentë sille që nesër e kalojnë ama nuk mund të marrë unë përsipër kur ai merr nga universiteti.

Alime Hoxha . Edhe kjo duhet parë nga ana atë e thamë duhet parë nga ana ligjore nëse mundemi apo s'mundemi ne t'ja japim sepse me sa di në në dijeni ka qenë që deri në vitin 2019 bashkia ka ndihmuar me ndihmë me bursat nxënësit jo muaj për muaj ja ka dhënë në formën e



një shpërblimi. Mbas 2019-ës 2020 kjo është heq pikërisht për këtë arsye sepse merren nga universiteti. Tani kjo duhet parë mirë thashë nga ana ligjore nëse ne na lejohet apo nuk...

Edison Memolla . Ka pas ardhur fond i deleguar për këtë.

Alime Hoxha . Po pra tani nuk vjen më, po pra se tani pikërisht kë po them unë tani a ka mundësi bashkia, nëse e marrim ne si vendim kemi bazën një e dyta dhe tjetra është thashë kjo duhet parë dhe kjo pjesa Orges që do ju ...

Edison Memolla . Më mirë e shikoni ju që jeni drejtori arsimore nxirrini nxënësit ekselentë...

Alime Hoxha . Nxënësit ekselentë i ke që sot , atë i nxjerr nuk është problemi tek numri i nxënësve, puna është si do ta bëjmë tani do ta bëjmë vetëm me këta që janë viti i parë sivjet apo do ndjekim dhe ata që janë vit të dytë edhe vit të tretë

Edison Memolla . Ta fillojmë me vitin e parë mendoj dhe të shikojmë ecurinë pastaj.

Alime Hoxha . Për arsimin parauniversitar për këtë që është këtu është ky propozim që themi ne klasat e 12 dhe nënta për këtë se nuk e bëjmë dot me të gjitha sepse shkon, këto janë jua kërkojmë ne dhe janë sa e kanë në mesataren mbi 9,8 apo sa janë ... Po flasim për pjesën e universitetit...

Edison Memolla . Zysh meqë jemi bashkë me drejtorinë arsimore nxirrni ju lutem nëse keni mundësi pjesën e studentëve dhe zyra e financës tek ne mbasi të nxjerri koston kësaj gjëje

Silvana Aliu . Kryetar të them diçka ti ndihmo ato familje që janë në nevojë dhe kanë çuar një nxënës në shkollë me zor ajo familje ...

Enver Memolla . E thashë juridikisht... thuaj sa është fondi ja dalim apo nuk ja dalim kaq .

Edison Memolla . Shumë shpejt do e kemi nga ana jonë ndoshta tek grupet paraprakisht që ta shikoni nëse ja vlen që ta...

Enver Memolla . Kryetar nëse kjo del që duhet bërë dhe keni gati pjesën ligjore dhe pjesën e të ardhurave hajde dhe sille në këshill bashkiak e diskutojmë.

Edison Memolla . Ndoshta edhe ne si bashki nuk e përballojmë dot,.



Enver Memolla . Po këtë jam duke thënë, nxirr bazën ligjore financiare bashkë me zyshen bëni planin e punës na e sillni.

Mukades Gixhari . Atëherë kalojmë në projektvendimet e reja që i futëm sot në rendin e ditës. Projektvendim për miratimin e kërkesës së zotit Hekuran Dedej, ky projektvendim ka marrë miratimin dhe të komisionit të financës që është mbledhur ditën e djeshme ora 13:00 . E hedhim në votim. Pro, kundra, abstenim. Të gjithë pro miratohet.

-Miratohet me 11 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, projektvendimi me shkresë Nr.5080.Prot datë 25.11.2025 “Për miratimin e kërkesës së z. Hekuran Dedej”.

Vendim nr.47. Miratohet me 11 vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.5080.Prot datë 25.11.2025 “Për miratimin e kërkesës së z. Hekuran Dedej”.

Mukades Gixhari . Kalojmë në projektvendimin për miratimin e kërkesës së Shoqatës Humanitare “3 Dhjetori”. Ky projektvendim nuk ka marrë miratimin e komisionit të financës i cili është mbledhur ditën e djeshme.

E hedhim në votim, pro kundra absenim. Ta hedhim në votim ta themi jo-në me gojë. E hedhim në votim pro, kundra, absenim. Të gjithë kundër. Nuk miratohet.

-Me 0 vota pro, 11 vota kundër, 0 vota abstenim nuk miratohet projektvendimi, me Nr. 4349/2.Prot datë 25.11.2025 “Për miratimin e kërkesës së Shoqatës Humanitare “3 Dhjetori” “.

Alime Hoxha . Meqë jemi po këtu që është diskutuar dhe në komision, ne menduam që këtyre fëmijëve jetim nëse është e mundur nga ana e bashkisëmos t’i jepnim atë 500 mijë lekëshin për të bërë atë ekskursionin po le të jua japim lekë .

Mukades Gixhari . Në rregull, kalojmë në projektvendimin tjetër për shpalljen “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) z. Ramazan Thartori. Për këtë çështje kemi bashkangjitur dhe raportin e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit të cilët janë mbledhur me datën 10.11.2025 dhe janë shprehur pro dhënies së titullit të zotit Ramazan Thartori. Në lidhje me këtë projektvendim, komisioni i titujve po znj. Fatmira, po z. Indrit.

Indrit Dedej . Po kemi rënë dakord.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim, pro, kundra, absenim. znj. Silvana? Miratohet. 10 pro një abstenim Fatmira Thartori përjashtohet nga votimi pasi ka konflikt interesi .



-Miratohet me 10 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, (znj. Fatmira Thartori përjashtohet nga votimi pasi ka konflikt interesi) projektvendimi me shkresë Nr.5103.Prot datë 26.11.2025 “Për shpalljen “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) z. Ramazan Thartori”.

Vendim nr.48. Miratohet me 10 vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.5103.Prot datë 26.11.2025 “Për shpalljen “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) z. Ramazan Thartori”.

Mukades Gixhari . Kemi dhe shkresën kthim përgjigje për këshilltarin z. Mitat Daja, që e keni të gjithë kjo ishte sepse për znj. Hava Dedej e bëmë tani zonja Gëzime Metasani ta dëgjojmë pak.

Gezime Met-hasani . Unë e kam vënë në dijeni edhe herë tjetër për një depozitë atje tek shkolla që akoma s’është vënë edhe një fuçi dy kuintalëshe sepse është për rrezikojnë kalamajtë.

Edison Memolla . Nëse nuk zgjidhet sot do iki drejtoresha.

Gezime Met-hasani . Nuk e di për drutë kanë sjellë apo jo, edhe diçka tjetër dritat shyqyr që na u rregulluan por vetëm tre drita janë ndezur.

Edison Memolla . Kemi problem sa të bëjmë kontratën e energjisë me ...sa të na zbardhet kontrata s'na e lë ta lidhim me energji kështu.

Gezime Met-hasani . Ok, se rruga shyqyr zotit është bërë gjë e mirë atë ajo rruga atë që ishte burim aksidenti .

Edison Memolla . Më shkruajti ky shefi i policisë...

Mukades Gixhari . Shefi i policisë ktheu përgjigjen.

Edison Memolla . Një përgjigje dhe më thotë që nuk arrit të vi dot mbledhje se kështu kam pasur një konflikte kështu që për mbledhjen e ardhshme do të jem i gatshëm që t’ju vejë në dijeni që është marrë informacioni.

Mukades Gixhari . Zoti Enver Memolla. Faleminderit kryetar.

Enver Memolla . Meqë jemi tek të ndryshme zyshe këtë prita prandaj ndenja më shumë...



kohët e fundit kemi hasur pak probleme me motin e keq dhe jemi në vënë pak a shumë tek grupi. Spaskam drejtorin e bujqësisë këtu, në pjesën e Shkumbinit të na kishte dhënë një informacion të detajuar për pjesën sidomos Rrogozhinën e njoh se e kam shkel vetë këto ditë po për pjesën e Gosës, Kalushit poshtë Vilë. Këtu me drejtorinë e shërbimeve kam një kënaqësi vetë personalisht në situatë emergjente, në rrugën dalëse Rrogozhinë - Peqin për pesë ditë të rri bllokuar puseta dhetë mos largohen ujërat duke rrezikuar dhe jetën e shoferëve që janë në makinë kam qenë vetë i rrezikuar që jam spostuar nga uji gjynah. Tani aty kanali përroi shkarkues i Shimëveve është 33 m dhe kam matur me 33 hapa është gjynah Val që në mes të Rrogozhinës të bëj unë aksident. Sepse thashë ishte ora 2 e drekës se themi natën ta bëj hallall, ora 2 e drekës. Edhe tek rruga lart nuk është parë asnjëri tek lagja ime sot do tank të shkosh se makina im është bërë kështu është bërë si djep.

Valimra Troka . Tek lagja jote...

Edison Memolla . S'është lagja Verit se është e të gjithëve.

Enver Memolla . Një sekondë s'kam mbaruar akoma ...se e keni bërë rruga e Verit kanali i Verit... Problemi është i madh tek ajo lagje të paktën gjysmën nuk keni mundësi ta rregulloni por gjysmën keni mundësi ta rregulloni. Janë 240 m që mund të bësh kanal anësor në dy krah është gjynah, përse i përket pastaj një problem madhor është kthesa te shtëpia e Tos Aliut tek Kushi që është bërë me asfalt dhe nuk ka shikueshmëri duhet patjetër një pasqyrë aty sepse është shumë problem aty ka shumë fëmijë të vegjël që nga momenti në moment mund të përplasesh, si me monopatinë si me makinë si në këmbë, se nuk ka fare shikueshmëri, ose dy policë të shtrirë që ndërrojnë dhe kjo pjesë... është shumë keq ajo pjesë aty.

Edison Memolla . Është më mirë policë i shtrirë...

Enver Memolla . Sepse edhe kur del nga avullia që del tek hekurudha që dalin kalamjatë e vegjël nuk ka fare shikim dhe aty u bë hata para një jave që vdiq fëmija dy vjeç. Brenda po aty u bë po gjynah.

Edison Memolla . Për pjesën aty jemi dakort se e kam parasysh...

Enver Memolla . Pastaj për pjesën poshtë nuk e di nëse keni evidencë kemi disa toka të përmytura nuk e di nëse janë të mbjellura tek ish pompa e vjetër kanë ngelur diku tre ditë ujë aty bëhet fjalë tek blloku poshtë Gimit ndoshta mund të ketë dhe njerëz tjerë nuk e di ka pas dalje, aty ka pasur dalje për të pasur. Aty ka pas dalje ka qenë një gati një bllok me zyshen e kam



folur por realisht kjo pjesa e rrugëve sidomos ajo rruga që vjen tek Aliajt lart që ka bllokuar puseta e rrugës së re dhe është bërë dhe ajo pengesë. Tani ajo rruga e lart o do merret masë që të bëhet një kanal me kryetarët e futesh po tek ... ose s'ke çfarë bën se ajo të bëhet problem shumë madhor është gati 300 metër rrugë, këto po këto realisht kjo kjo e këtyre...

Edison Memolla . Nuk e di duhen marrë masat edhe nga ato kamionët që pastrohen kështu që kjo është gjë që besoj që zgjidhet nuk është për pjesën e kësaj, asfaltit që po flasim aty është tek kthesa e lagjes aty është gjë që zgjidhet dhe kështu që shumë shpejt duhet zgjidhur ajo. Se unë kam qëlluar dhe vetë dhe e kam parasysh për çfarë po flet, se ka të përgjegjshëm ka dhe të papërgjegjshëm keq kur ka rrugë keq kur nuk ka. Kështu që e kuptoj këtë pjesë kurse për pjesën e lumit realisht fatmirësisht nuk kemi pasur përmbytje dhe edhe nga Gosa edhe nga ... përveç se në fshatin Vilë, ku bën mjekën e madhe e lumi ka pasur disa dalje por nuk ka kaluar përtej tokave bujqësore lumi, kështu që fatmirësisht edhe falë pastrimit të kanaleve që ne kemi bërë gjatë gjithë kësaj kohe. Me mjetet që ne kemi blerë por dhe me bordin e kullimit nuk kemi pasur përmbytje. Ndoshta pjesë të vogla parcela që ju thoni nuk jam në dijeni. Nëse do ketë nevojë për pastrim do e bëjmë dhe pastrimin dhe nuk e di për çfarë linjë tjetër pjesën e rrugës së lagjes që jetoj unë aty kaloj jetoj aty. Është e vërtetë, ne i kemi mbaruar të gjithë ato se thotë pa lezet dhe ne kemi bërë projektin i kemi çuar dhe s'kemi marrë financim. Por realisht kemi bërë një projekt goxha të mirë për të gjithë lagjen edhe aty do vënë dorë siç edhe ju e dini jo vetëm në zona të tjera që kanë nevojë por dhe në zona që jetojnë njerëz në ato lagje dhe është e vërtetë.

Me buxhetin e bashkisë ne nuk mund ta realizojmë dot se është goxha i madh sepse ka, nëse do të bëjmë një rrugë është me nëntokësor mbitokësor me ndriçim e të gjitha. Edhe shembjet e mureve shpronësimet që duhet të bëhen sepse duhet të kalojnë dy makina të paktën, kështu që për këtë nuk kam të them... por projekti është realisht, është i dërguar ministrisë së financës, infrastrukturës, që të gjithëve. Unë kam pasur iniciativë personale po e them publikisht që ajo zonë është një nga objektivat që kam pasur që kur kam ardhur shpresoj që do e arrij.

Enver Memolla . Atë rrugën aty e prish komplet uji që vjen nga lart, unë ta ka thënë njëherë personalisht që aty mund të bësh vetëm një investim të vogël, tek depo ujit për pjesën e ujit lartë ta presh aty dhe kjo pjesa poshtë, nën shtëpisë ku të hapet krytëzimi që shkon tek rruga e Kacanve ta kapësh kanalën anësor dhe ta bësh që të paktën kursen 500 metra pa e prish. Është gjë që nuk kalohet sot, aty janë dhe dy muaj që rrezikojnë shembjet ta kam thënë dhe njëherë edhe pak mos me vënë dorë.

Mukades Gixhari . Ndonjë shqetësim tjetër meqë jemi ...

Silvana Aliu . Z. Kryetar kemi kordinatore dhune në bashki?



Edison Memolla . Dhunën ndaj gruas? Ka bërë dorëheqjen.

Silvana Aliu . Ok, atëherë është një vend i rëndësishëm të paktën po flasim për situatën e tjetrit dhe të merren masa që...

Edison Memolla . Po e mbulon përgjegjësja e zyrës.

Enver Memolla . Edhe diçka për pjesën e varrezave duket që po mbushet.

Edison Memolla . Kemi edhe shkresat po mundohen ta fusim për shponësim të dyja këto kanë nevojë ajo është caktuar zonë për varreza.

Enver Memolla . Është caktuar se është bërë dhe niveli i murit që me kohë.

Edison Memolla . Zonën në plan vendor është zonë varrezash, por siç e dini ne shqiptarët do kemi qejf të mbjellim ullinj, fiq dardha aty. Kjo e ullirit çik problem dhe me vendim nuk do shkulësh dot pastaj.

Mukades Gixhari . Zonja Fatmira Thartori.

Fatmira Thartori . Atëhere tregu i Gosës doja të ngreja një shqetësim për tregun e Gosës. Pozicioni që ajo është aty nuk është shumë i përshtatshëm, jo shumë por nuk është i përshtatshëm. Mendojmë edhe me miratimin e gocave që janë këshillare të pjesës tjetër të opozitës, Tashës edhe Merit që ai pozicion të ndryshojë, sepse nëse duhet të bëhet ndonjë devijim i rrugës aty në momentet që zhvillohet tregu ose duhet të ndryshohet po aty ku ka qenë tek pallatet jo tek zona private s'jamë tek privati por të jetë më e përshtatshme tek zona e pallateve ... e shikojmë.

Edison Memolla . Shiko e kemi marrë si shqetësim kemi parë të gjithë mundësitë por duke ditur që është treg më i madh edhe aty do ketë abuzim pastaj do hyjnë tek privati, do hyjnë te ai, do i marri lekët ai, tjetri tarifën... duke i vendosur aty që edhe mos i marr tarifa se ne jemi dashamirës.

Fatmira Thartori . Po, gjithmonë t'i marri bashkia.

Edison Memolla . Nëse ne shkojmë aty, ato do shkojnë se e kemi provuar.



Fatmira Thartori . Nëse privati ka kushte i plotëson.

Edison Memolla . Nuk ka asnjë kusht privati. Për mua është të ndalojmë makinat jemi ok të shohim mundësinë.

Fatmira Thartori . Është kjo se do kalosh aty me makinë dhe ai mezi ecën, mezor lëviz.

Besnike Coraj . Është e vështirë ditën e tregut ka shumë lëvizje, se tregu nuk është i vogël.

Mukades Gixhari . Zoti Indrit ta dëgjojmë pak se është është banore edhe jeton aty nonstop.

Fatmira Thartori . Po ti je vetëm thjeshtë e shikon me atë syun e vizitorit nuk e shikon me syun e banorit, ne jetojmë aty.

Mukades Gixhari . Një herë në javë që është të kufizohen makinat.

Edison Memolla . Mund të kufizosh kamionët por makinat...

Enver Memolla . Ka një problem parkimi si tek bashkia si tek kopshi si tek shkolla, bëj tre parkime për shkollën.

Fatmira Thartori . Mbetemi tek pjesa e Gosës o kryetar shikoje njëherë.

Edison Memolla . Mendimi im është ndalimi i makinave që të bëhet, po makinat nuk mund të ndalohen të gjitha do ndalosh... rezidentët do të kalojnë se do shkoj në shtëpi ai.

Fatmira Thartori . Po do shkoj po pra, dhe kjo është pjesa ose devijim, mund t'i devijosh nëpër lagje, ke një pjesë aty duke filluar që nga ...ta bësh atë pjesën aty që të devijoj makinë se s'kemi nga mbrapa se nuk ka mundësi.

Edison Memolla . Ok, ne do e marrim do kemi bashkëbisedim edhe me ju që jeni të zonës, hajde të shikojmë nuk jemi kundra.

Silvana Aliu . Kjo është një kërkesë meqë drejtoresha arsimit është këtu e zyrës arsimore. A mund të financoni në shkollën Qamil Gjuzi për një klasë burimore ? Sepse mesa jam në dijeni tek shkolla pranë kanë ardhur të paktën ta kemi.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

Alime Hoxha . Duhet bazë materiale për klasat për nxënësit me aftësi kufizuar pra që kanë probleme. Këto kanë një klasë të veçantë që quhet klasë burimore dhe ajo duhet të pajiset me disa mjete që janë posaçërisht për këto, do ju nisim ne një kërkesë për këto mjete që jo vetëm për shkollën e Qamil Gjuzit por edhe për shkollat e tjera se kemi dhe shkolla të tjera.

Edison Memolla . Po si funksionon zakonisht nëpër shkollat e tjera e kemi bërë ne?

Alime Hoxha . Ne, praktikisht bën edhe aq sa ka mundësi të bëjë bashkia bën dhe ministria. Ne do nisim shkresat për të dyja edhe për juve dhe për ministrinë.

Edison Memolla . Ne na vini në dijeni...

Alime Hoxha . Do i kërkojmë të dyjave.

Silvana Aliu. Më shumë vjen si tip dhurate nga ai që ndërton shkollën, po ai që ndërton shkollën ...?

Edison Memolla . Jo varet nga projekti.

Alime Hoxha . Realisht ato mjete janë të domosdoshe.

Mukades Gixhari . Pyetje të tjera? Meqë nuk keni më pyetje dhe diskutime mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Faleminderit.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 14 : 00⁰⁰ . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 01 orë 31 min ; 49 sek.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen **35 (tridhjetë e pesë)**.

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera